

## AKTI I THEMELIMIT

### I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “ Technomind - Albania ” Sh.p.k.

#### NENI 1

Ne Sarande sot me daten 15.07.2024 shtetasit e poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar: “ Technomind – Albania ” Sh.p.k.

#### NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise do te jete ne adresën: Vlore, Sarande, Lagjja nr.2, Rruga Lefter Talo, Godina nr. 153, Kati 1.

#### NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.  
Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

#### NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: “ Technomind – Albania ” Sh.p.k. do te jete: Dizajni, programimi, zhvillimi, mirembajtja dhe shitja e programeve softwerike per teknologjine e informacionit dhe telekomunikacionit, dizajnimi grafik, zhvillimi dhe mirembajtje e faqeve web, menaxhim projektsh te teknologjise se informacionit.

#### NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njqindmije) leke, formuar dhe nenshkruar nga 2 ortak ose 2 kuota .

- Ortaku themelues: Gjergji Bushi: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhjetë mijë) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues: Ernedo Selami: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesedhjetë mijë) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme.  
Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqerise mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazen e vendimit me shkrim qe merr Asambleja e Ortakeve, i cili nenshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke

bere dhe shenimet ne regjistrin perkates. Ne keto raste, vendimi merret nga ortaket qe perfaqesojne 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

#### NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise , te ruajne sekretin e saj dhe te mos te demtojne interesat e personave te tjere te shoqerise.

#### NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke dhe ne cdo lloj valute te huaj, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

#### NENI 9

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1-Asambleja e Ortakeve

2-Administratori

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve dhe Administratorit do te percaktohen ne statutin e shoqerise tregtare " **Technomind – Albania** " **Sh.p.k.**

#### NENI 10

Shoqeria do te drejtohet nga Administratori i saj Z. Gjergji Bushi per nje afat 5 vjecar.

#### NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirekuptim, ne të kunderten kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarande.

#### NENI 12

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, vecanerisht me ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe shoqerite tregtare" (te ndyshuar).

#### NENI 13

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### NENI 14

Akti i themelimit u perpilia ne 2 (dy) kopje dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaket themelues.

### Themeluesit e shoqerise

Gjergji Bushi

Ernedo Selami